



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

PRISHTINË, 14 DHJETOR 2010
NR. REF.: RK 41/10

VENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 03/09

Nexhmedin Llumnica

kundër

Vendimit C1. nr. 618/02 të Gjykatës Komunale të Prishtinës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare, dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Njëzëri miraton këtë vendim për papranueshmëri.

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Nexhmedin Llumnica, me banim në Prishtinë.

Vendimi i sfiduar

2. Vendimi C1. nr. 618/02 i Gjykatës Komunale të Prishtinës, i 11 gushtit 2008.

Çështja e lëndës

3. Parashtruesi i kërkesës pohon që të drejtat e tij të garantuara me Nenin 46 (Mbrojtja e pronës) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës janë shkelur. Ai kërkon që

Gjykata: (1) t'i suspendojë të gjitha veprimtaritë ekonomike të ndërmarrjes Melrose Investment Group në Kosovë, dhe (2) t'i caktojë 800 milionë euro si kompensim për këtë shkelje.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme - Kushtetuta), Neni 20 i Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme - Ligji), dhe Neni 54(b) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme - Rregullorja e punës).

Përmbledhje e procedurës para Gjykatës

5. Më 18 shkurt 2009, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese.
6. Më 23 shkurt 2009, Sekretariati i Përkohshëm i Gjykatës Kushtetuese e njoftoi parashtruesin e kërkesës se Gjykata e kishte pranuar dhe regjistruar kërkesën e tij, dhe se do ta shqyrtonte atë sapo Gjykata të bëhej plotësisht funksionale.
7. Më 3 tetor 2009, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e caktoi Prof. Dr. Ivan Čukalovićin Gjyqtar raportues.
8. Më 15 dhjetor 2009, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtari Robert Carolan, kryesues, dhe gjyqtarët Altay Suroy dhe Snezhana Botusharova.

Përmbledhje e fakteve

9. Parashtruesi pohon se ishte bashkëpronar, me Riza Llumnicën, i ngastrës kadastrale 2653/11656/3, të regjistruar në fletën poseduese nr. 2265 në KK të Prishtinës.
10. Më 25 nëntor 1974, Sekretariati për Ekonomi dhe Financa i KK të Prishtinës eksproprijoi ngastrën kadastrale 2653/11656/3, të regjistruar në emër të Hysen Bajram Llumnicës. Asnjëri prej pronarëve të pronës nuk e kundërshtoi këtë vendim dhe Sekretariati u ofroi atyre parcela të tokës në lokacione të tjera si kompensim (Vendimi nr. 05-464-74, i 25 marsit 1974)
11. Në vitin 1998, parashtruesi paraqiti kërkesë pranë Drejtorisë për Pronë dhe Çështje Ligjore të komunës së Prishtinës për deksproprijimin e pronës në fjalë. Sapo mori kërkesën, drejtorja e njoftoi parashtruesin e kërkesës se ai duhej t'ia bashkëngjiste kërkesës vendimin për eksproprijim.
12. Më 10 maj 2001, parashtruesi i kërkesës dhe Riza Llumnica paraqitën kërkesë pranë Drejtorisë për Pronë dhe Çështje Ligjore të komunës së Prishtinës për deksproprijimin e pronës në fjalë.
13. Më 3 tetor 2002, parashtruesi i kërkesës dhe Riza Llumnica iniciuan procedurë pranë Gjykatës Komunale të Prishtinës, ku kërkonin njohjen e të drejtave të tyre pronësore për ngastrën kadastrale 2653/3.
14. Më 8 maj 2003, parashtruesi i kërkesës dhe persona të tjerë lidhën kontratë pune me ndërmarrjen Melrose Investment Group nga Tirana. Sipas kushteve të kontratës, parashtruesi i kërkesës dhe partnerët e tij ishin të detyruar t'ia shitnin ngastrën

kadastrale 2653/3 ndërmarrjes Melrose Investment Group në shkëmbim për tri banesa.

15. Pas një kohe, ndërmarrja Melrose Investment Group, inicioi procedurë për shkelje të kontratës duke pohuar që parashtruesi i kërkesës kishte dështuar t'i përmbushte dispozitat e kontratës lidhur me vërtetimin e të drejtave pronësore.
16. Më 11 gusht 2008, Gjykata Komunale e Prishtinës konstatoi që nuk kishte kompetenca të merrej me këtë çështje sepse vetëm organi që e kishte miratuar vendimin fillestar për eksproprijim ishte kompetent për ta anuluar atë vendim (C1. nr. 618/02).

Vlerësimi për pranueshmërinë e kërkesës

17. Neni 113.7 i Kushtetutës thotë:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

18. Neni 48 i Ligjit thotë:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".

19. Parashtruesi nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi *prima facie* që mbështet shkeljen e të drejtave të tij sipas Kushtetutës (shih *Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së lidhur me pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, të 31 majit 2005*). Parashtruesi nuk saktëson si Kushtetuta e mbështet pohimin e tij, siç kërkohet me Nenin 113.7 të Kushtetutës dhe Nenin 48 të Ligjit. Prandaj, kërkesa duhet të hidhet poshtë qartazi si e papabuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me Nenin 20 të Ligjit, dhe Nenin 54(b) të Rregullores së Punës, në seancën e datës 14 dhjetor 2010, njëzëri:

VENDOS

- I. **TA HEDHË POSHTË** këtë kërkesë si të papranueshme.
- II. Sekretariati do t'ua komunikojë këtë vendim palëve dhe do ta publikojë atë në Gazetën Zyrtare, në pajtim me Nenin 20.4 të Ligjit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Prof. Dr. Ivan Čukalović, d. v.



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani, d. v.